



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia.org. Org.Jedlinca Org.Unit	58-02
Nr.i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-04-
Nr. i Prot. Liraf. Prot. Prot. No.	8380-2/24
Datë Datum Date	29.04.21
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	24.02.2025
REFERENC-Ë:	8380/24 ZSP - 2025
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Shërbime Publike, K. Junik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së; Z. Agron SHALA , U.D., Drejtor i ARPL-së; Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të Drejtën Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pëlqim ujq

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në kërkesën me Nr. Protok. 8380/24, datë 19.12.2024, lidhur me projektin "Pastrimi i shtratit të kumit Ereni" në K. Junik, me gjatësi L=2.0 km. Pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. PU

Datë: 24.02.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, U.A. MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa për Pëlqim Ujor për kalim në kompetencë të Komunes Junik, me nr. Protok. 8380/24, për projektin "Pastrimi i shtratit të Lumit Erenik" në K. Junik, me gjatësi L=2.0 km:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, bazuar në pikat gjeodezike, për pastrim në gjatësin e Lumit, L= 2.0 km. Andaj si i tillë ruhet nga pala, nën kushtet si në vijim:
2. Pastrimi i segmentit të lumit Lumbardh i Deçanit, të relizohet sipas projektit, në gjatësin L = 2.0 km, të hartuar nga kompania, me të cilën kompani K. Junik do të bie në ujdi për pastrimin e lumit;
3. Materiali i deponuar për shkak të grumbullimit të mundëshëm, për të cilin parashihet nevoja për largim, ku konsiderohet se pengon lëvizjen e natyrshme të ujërrjedhës, që parashihet si rrezik potencial të krijimit të vërshimeve. Organi Komunal i cili është i obliguar të bëjë mbikqyrjen e zhvillimi të punimeve të cilat duhet të jenë në përpuethshmëri të plotë me dispozitat ligjore për ujëra, njëkohsisht duhet ti paraqes profilet, ku është njerrë materiali, të kalkuloj kubaturën si dhe të bëjë pagesën e materialit sipas dispozitave të parapara në fuqi;

4. Elaborati i dinamikës së nxjerrejes së materialit, dhe rehabilitimi pas këtijë aktiviteti të prezantohet në formë ditari për secilin segment, në MMPHI, konformë “U.A. MMPH 03/2018, për procedurat për leje ujore”;
5. Pëlqimi uxor ka afat një vjeçar, dhe pas kalimit të kësajë periudhe kohore, pala duhet të bëjë kërkesë të veçant, po që se paraqitet nevoja, sepse aktualisht me legjislacionin në fuqi nuk parashihet ndryshe;
6. Pëlqimi uxor për nxjerrjen e materialit ndërpritet edhe para afatit të përcaktuar nga paragrafi si më sipër, nëse gjatë kontrollit nga inspektorati i ujërave komunal dhe qendrorë, vërtetohet se kryesi i punëve nuk iu është përmbajtur kushteve të përcaktuara me pëlqim uxor;
7. Raportet duhet të jenë të nënshkruara dhe me datë, në ditën kur janë kontrolluar nga organi mbikqyrës i Komunës së Junikut;
8. Vendi për deponimin e materialit, duhet të jetë i caktuar, dhe me prezantim të ngastrës së paraparë dhe për çdo ndryshim pala duhet ta informoj Organin i cili e ka lëshuar këtë Pëlqim Uxor;
9. Pala detyrohet që të bëjë inçizimin gjeodezik të shtratit të segmentit të lumit të pastruar, pas kryerjes së punimeve dhe të njëjtin ta prezantojë pranë Organit që e ka lëshuar Pëlqimin uxor;
10. Pastrimi i dërrunjëve nuk është në Kompetencë të MMPHI-së dhe duhet të kërkohej nga organi përgjegjës, sepse ARPL-ja nuk ka kompetenca përveq se organi kompetent;
11. Punëkryesi i detyrohet MMPHI-së, që materialin ranor dhe gurorë të larguar ta prezantojë realisht si dhe vendëndodhjen, pranë organit përgjegjës që e ka lëshuar këtë Pëlqim uxor, për shkak të vlerësimit financiar, sipas U.A për strukturën e pagesave në fuqi;

ARSYETIM

Pala, Komuna e Junik – “Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim”, ka aplikuar për Pëlqim Uxor, lidhur me “Pastrimi i Lumit Erenik” L=2.0 km (L=1,800.0 m’ K. Junik dhe L=200 m’ në fsh. Jasiq-Gjocaj, K. Junik); Kërkesës i ka bashkangjitur: Autorizimin për Ing Rijad Zejneli, për të kryer studim hidrologjik dhe hidraulik të segmentit prej 2 km të Lumit Erenik, në K. Junik nga “Geo – Points”; Raport të hartuar nga Shkelzen Shehu, Ministria e punëve të Brendshme; nr 9-180/10202; datë 03.11.2013; 12 (dymbëdhjet foto); Faturen e pagesës me rastin e aplikimit“ Qëllimi i pastrimit: mbrojtja nga permbytjet; Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe Mjedisit; Promovimi i shëndetit publik; Zhvillimi i turizmit dhe rekreacionit; Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit; përmirësimi i infrastrukturës Lokale; Parcela e studimit për pastrim; Studimi: Objektivat e studimit , qëllimi i kryesor dhe rendesi e studimit; Të dhënat dhe informacionet bazë; Të dhënat hidrologjike; të dhënat hidraulike; të dhënat meteorologjike; modelimi i rrjedhes; Bilanci hidrologjik; profili i ujit; Identifikimi i pengesave; Strategjia dhe masat e pastrimit; Masat e mbrojtjes dhe pastrimit;

Masat e mbrojtjes dhe Përmirsimit; Analiza e rrjedhave dhe e përmbajtjeve; Reshjet maksimale; Situacioni dhe profili gjatësor për Lumin Erenik (matje gjeodezike çdo 25m), hartuar vulosur dhe nënshkruar nga “Geo Point”; Raporti përfundimtar dhe rekomandimet (Profili gjatësor; Prerjet karakteristike tërthore);

Vërejtje:

- Ky projekt do të realizohet, me qëllim të mbrojtjes së regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit,
- Poashtu K.Junik thekson se pastrimi i shtratit të lumit është më se i nevojshëm pasi që janë barrtur mbeturina të shumta brigjeve të tijë, të cilat po pengojnë rrjedhën e ujit dhe në raste të vërshimeve ato po depërtojnë në tokat bujqësore dhe shtëpi banimi;
- Nëse vie deri te prishja e regjimit të ujërrjedhës, ose i shkaktohet dam palës së tretë, gjatë realizimit të punimeve, punëkryesi detyrohet që dëmet ti eliminoj dhe të njejtat ti kompenzoj;

Andaj bazuar në kërken e K. Junik, për “Pastrimi i shtratit të Lumit Erenik” dokumentacionit – investivo teknik të hartuar, shikimit në vend, me datë 06.02.2025, ku me kete rast është bërë procesverbalin në mes të Përfaqësusit të palës dhe zyrtarëve të ARPL-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të njëjtë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 8380/25 – ZSP - 2025 Datë: 24.02.2025

Prishtinë

T’i dërgohet:

- Komunës Junik;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së



Izedin BYTYQI